



**RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK “PËR VERIFIKIMIN E
ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
MËPARSHME TË EVADUARA PËR PERIUDHËN E
GJASHTËMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2023**

**RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK
“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA”**

PËR PERIUDHËN E GJASHTËMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2023

**MBI AUDITIMIN ME TEMË: “PERFORMANCA E SISTEMIT TË SHFRYTËZIMIT
MINERAR TË MERMERËVE”**

NË SUBJEKTET:

- ✓ **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**
- ✓ **MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**
- ✓ **AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**
- ✓ **AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE**

Prill 2025

PËRMBAJTJA

I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3	3
I.1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	3
I.2	Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh	3
I.3	Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh	3
I.4	Statusi i pranimit të rekomandimeve	3
II	HYRJA	4
II.1.	Objekti i auditimit	4
II.2.	Qëllimi i auditimit	4
II.3	Metodologjia e auditimit	4
II.4	Konkluzioni	5
III	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	5
III.1	REKOMANDIME PËR NDRYSHIME LIGJORE	6
III.2	REKOMANDIME PËR MASA ORGANIZATIVE	11
IV	TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE	14
V	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	15

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 1478 prot. datë 12.12.2024 të miratuar nga Kryetari i KLSH-së,ka kryet auditimin me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023 ” lidhur me auditimin e performancës me temë “Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve” në institucionet:

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit
4. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Audituesit e KLSH janë fokusuar në auditimin mbi hartimin e planit të veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna, për marrjen e masave të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë objekt, ku rezultuar si në vijim:

Mbi respektimin e afateve të raportimit

2. Respektimi i afatit ligjor prej 20

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk kanë përcjellë në KLSH *Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH*, në mos përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore: Nga auditimi u konstatua se, AKBN ka përcjellë në KLSH Planin e masave (me shkresën nr 11/2 datë 23.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 448/20 datë 25.01.2024) mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin me temë “Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve”.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh.

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e kësaj kërkesë rezultoi se:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Agjencia Kombëtare të Mjedisit nuk kanë respektuar afatin **prej 6 muajsh**, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky në mospërputhje me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit me temë “Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve”;

- në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 448/14 datë 29.12.2023;
- në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 448/15 datë 29.12.2023;
- në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore me shkresën nr. 448/16 datë 29.12.2023;
- në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me shkresën nr. 448/17 datë 29.12.2023.

Raportin Përfundimtar, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të Auditimit të Performancës, me temë “Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve”.

Në këtë auditim, me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar 2 masë “Propozime për ndryshime ligjore” dhe 8 “Masa organizative” për zbatim. Nga 10 masat e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 10 masa ose 100 % e tyre.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimet të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	8	8	
2	Përmirësim ligjor	2	2	
3	Eliminim efektsh negative			
	Totali	10	10	

II. HYRJA

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme në subjektet e lartpërmendur mbështetur në programet respektive të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e gjashtë mujorit të dytë të vitit 2023”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit 1478 prot. datë 12.12.2024. për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, me temë “Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve”, miratuar me Vendimin nr. ----datë ---- të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH-së, me përbërje:

- A.G Përgjegjës Grupi;
- E. K Anëtare.
- E. H Anëtare.

II.1. Objekti auditimit:

Hartimi i programit (Planit të veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. të dërguara me shkresën e KLSH të e cituara në pikën I/4 të këtij Raporti, për auditimin e performancës me temë “Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve”.

II.2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

II.4. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet rezultoi se:

që tre prej tyre Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk kanë marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për të informuar KLSH^{ne} mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, ndërsa nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh në zbatim të ligjit të sipërcituar.

Po kështu, të gjitha subjektet e audituara nuk kanë marrë masa për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor. Afat ky i përcaktuar në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka marrë masa për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor.

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. -----, datë ----, janë lënë 10 rekomandime gjithsej, nga këto: 8 masa organizative; 2 masa për përmirësim ligjor. Nga verifikimi i dokumentacionit në MIE, MTM, AKM dhe AKBN, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH^{ja}, rezultoi se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Nga 10 masat e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 10 masa ose në masën 100 %.
Nga 10 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 2 masa ose 20 % tyre, dhe janë pa zbatuar 8 masa ose 80 %.

Në mënyrë të përmblëdhur statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Pa pranuar	Statusi i zbatimit			
				Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	2		1			1
b	Organizative	8		1			7

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet:

Nr.	Statusi i masave	Në numër	Në %
1	Totali	10	
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	10	100
	Nga të pranuarat:	10	Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar	2	20
2	Zbatuar pjesërisht		
3	Në proces		
4	Pa zbatuar	8	80

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Pavarësisht se rekomandimet janë pranuar nga të gjitha subjektet, niveli i zbatimit të rekomandimeve është i ulët vetëm 20%.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

III.1. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Për nënpyetjen 4.1.1 A janë hartuar dhe zbatuar politika dhe objektiva të përshtatshme në funksion të shfrytëzimit të mermerëve?

Gjetje nga auditimi 2:

Ligji mineralar dhe Ligji për Taksat Kombëtare nuk janë të harmonizuar me njëri-tjetrin sa i përket përdorimit të terminologjisë mbi mineralin e mermerit. Në Ligjin mineralar nuk përdoret emërtimi “mermer”, por gëlqeror i mermerizuar, ndryshe nga Ligji për Taksat Kombëtare i cili përdor emërtimin “mermer” në shtojcën nr. 2 të tij dhe për të cilin ka të përcaktuar edhe vlerën prej 4095 lek/m³. Kjo situatë sjell një konfuzion në përkufizimin e qartë të termit të mermerit e cila evidentohet edhe në përlllogaritjen e rentës minerare për subjektet që shfrytëzojnë GMMD.

2.1 Rekomandimi:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për harmonizimin dhe unifikimin e përkufizimit dhe përcaktimit të qartë të mineralit të mermerit në ligjin mineralar dhe atë për taksat kombëtare.

Në vazhdimësi

Përgjigje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk i është përgjigjur emailit zyrtar të dërguar nga grupi i auditimit në adresat e.s@infrastruktura.gov.al dhe b.k@infrastruktura.gov.al më datë 17.12.2024 si dhe Akt Verifikimit protokolluar në MIE me nr 269 prot datë 13.01.2025.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Për arsye të mos përgjigjes ndaj emailit të cituar më sipër si dhe Akt Verifikimit të cituar po më sipër, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pa zbatuar

Gjetje nga auditimi 3:

Nga të dhënat e AKBN-së evidentohet se subjektet që shfrytëzojnë mermerin nuk i kanë të siguruar me sigurim jete të gjithë punonjësit e tyre me justifikimin se jo të gjitha pozicionet e kanë të domosdoshme këtë lloj sigurimi. Kuadri ligjor e rregullator mbi shfrytëzimin mineralar të mermerit nuk përcakton asnjë kriter mbi pozicionet e punës të cilat duhet të mbulohen me sigurim jete nga aksidentet në punë.

3.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masa për të përditësuar kuadrin ligjor e rregullator duke vendosur kritere të qarta lidhur me sigurimin e detyrueshëm me sigurim jete nga aksidentet në punë në varësi të pozicioneve të punës në aktivitetet e shfrytëzimit mineralar.

Mars 2024

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Ky rekomandim është zbatuar nga Drejtoria Minerare dhe Sektori i Monitorimit Mineralar në AKBN. Bazuar edhe në VKM nr. 1109, datë 30.07.2008 “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë” çdo subjekt mineralar, paraqit pranë komisionit të Miratimit të Planeve Vjetore të Punës, listën e punonjësve të siguruar, policat e sigurimit dhe profesionin për çdo punonjës të siguruar.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: I zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

III.2. MASA ORGANIZATIVE

Për nënpyetjen 4.1.1 A janë hartuar dhe zbatuar politika dhe objektiva të përshtatshme në funksion të shfrytëzimit të mermerëve?

1. Gjetje nga auditimi: Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë është e mangët, pa indikatorë matës për të gjithë periudhën e veprimtarisë së saj (2010-2025) për disa aspekte të ndryshme si për shembull vlera e investimeve në sektorin minerar, numri i punonjësve të punësuar në sektorin minerar dhe nën sektorët e tij etj. Lidhur me Monitorimin dhe Raportimin mbi ecurinë e Strategjisë Minerare të Shqipërisë nuk është përgatitur asnjë Relacion/Raport që të dëshmojë mbi synimet dhe objektivat e saj. Në Strategjinë Minerare të Shqipërisë nuk përcaktohet ngritja dhe detyrimi i ndonjë strukture për të monitoruar treguesit e saj, ndryshe sa përcaktohet në Strategjinë Minerare të Suedisë.

1.1 Rekomandimi:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në hartimin e Strategjisë së re Minerare, të marrë masa për përcaktimin e indikatorëve për gjatë gjithë periudhës kohëzgjatjes së saj si dhe të përcaktojë qartë njësinë apo strukturën e cila do të monitorojë periodikisht atë.

Me miratimin e Strategjisë së re Minerare

Përgjigje e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk i është përgjigjur emailit zyrtar të dërguar nga grupi i auditimit në adresat e.s@infrastruktura.gov.al dhe b.k@infrastruktura.gov.al më datë 17.12.2024 si dhe Akt Verifikimit protokolluar në MIE me nr 269 prot datë 13.01.2025.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Për arsye të mos përgjigjes ndaj emailit të cituar më sipër si dhe Akt Verifikimit të cituar po më sipër, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pa zbatuar

Nënpyetja 4.1.2 Si ka qenë ecuria e të ardhurave të realizuara nga sektori i shfrytëzimit të mermerëve? (Trajtuar më hollësisht në fq. 27- 36 të Raportit Përfundimtar)

Gjetje nga auditimi 1:

Në sektorin e shfrytëzimit të GMMD, 63 % e lejeve minerare i përkasin emërtimit “Gëlqeror i mermerizuar”. Prodhimi në fund të vitit 2022 në sektorin e shfrytëzimit të GMMD rezulton 27,279 m³ nga 12,537 m³ që ka qenë në vitin 2020. Të ardhurat e subjekteve që shfrytëzojnë GMMD nga shitjet (brenda dhe jashtë vendit) rezultojnë të jenë 592,155,168 lekë për vitin 2022 duke shënuar një rritje të lartë në raport me të ardhurat nga shitjet për vitin 2020 të cilat kanë qenë 230,054,425 lekë. Volumi i produktit të shitur të GMMD (në m³) ka shënuar rritje nga 11,011 m³ në vitin 2020 në 24,927 m³ në vitin 2022. Pavarësisht rritjes së volumit të shitur mbi të cilin përlllogaritet renta minerare, ecuria e kësaj të fundit ka shënuar trend zbritës për periudhën objekt auditimi nga 13,320,612 lekë në vitin 2020 në 8,888,552 në vitin 2022.

Gjetje nga auditimi 2:

Përgjatë periudhës objekt auditimi rezultojnë disa subjekte të cilat në Lejen Minerare kanë emërtimin “Gëlqeror i mermerizuar” dhe nuk e paguajnë rentën minerare sipas përcaktimit të

Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Shtojca nr. 2, Grupi IV numri 22. I njëjti fenomen përsëritet edhe për subjekte të tjera të cilat në Lejen Minerare kanë emërtimin “Gëlqeror dekorativ” dhe nuk e paguajnë rentën minerare sipas përcaktimit të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Shtojca nr. 2, Grupi IV numri 36.

1.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për të gjithë subjektet që shfrytëzojnë Gëlqerorët Masiv, të Mermerizuar dhe Dekorativ, të marrë masa për të unifikuar pagesën e rentës minerare bazuar në emërtimin e mineralit që përmban Leja Minerare e shfrytëzimit.

Menjëherë e në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Në cdo rast, komisioni i Miratimit të Planeve Vjetore të Punës, pagesat e rentës minerare i kërkon bazuar në emërtimin e llojit të mineralit në Akt Miratimitin përkatës. Çdo subjekt që shfrytëzon, përpunon ose tregton GMMD, rentën minerare e paguan bazuar mbi vlerën e përcaktuar në Ligjin për Taksat Kombëtare (Ligjit nr 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare, i ndryshuar, shtojcat nr. 2).

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Rekomandimi i mësipërm lidhet me gjetjen nr.2 ku evidentohen disa subjekte të cilat përgjatë viteve të ndryshme nuk e kanë paguar rentën minerare sipas përcaktimeve ligjore të cituara në këtë gjetje. AKBN, në kthim përgjigjen e saj me nr. 105 prot. datë 09.01.2025 protokolluar në KLSH me nr. 1478/1 prot. datë 10.01.2025 nuk ka sjellë asnjë fakt apo evidencë të re lidhur me subjektet e referuara në Raportin Përfundimtar të auditimit mbi këtë fenomen, por vetëm ka përgjithësuar që pagesat e rentës minerare bazohen në emërtimin e llojit të mineralit në Akt Miratimitin përkatës. Duke qenë se nuk ka asnjë ndryshim lidhur me këtë situatë ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pa zbatuar

Nënpyetja 4.2.1 A janë miratuar kërkesat për heqje nga fondi pyjor të aktiviteteve të shfrytëzimit të mermerëve? (Trajtuar më hollësisht në fq. 36- 41 të Raportit Përfundimtar)

Gjetje nga auditimi 1:

Deri më sot asnjë prej subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit nuk janë të pajisur me aktin përkatës ligjor/nënligjor (Miratimin e Ministrit të MTM, VKM ose Ligj të veçantë) për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar. Ligji për pyjet përcakton qartë detyrimin e subjekteve për t’u pajisur me Miratimin e Ministrit të MTM, VKM ose Ligj të veçantë mbi ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar.

1.1 Rekomandimi:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat të shqyrtojë të gjitha kërkesat/aplikimet e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit, duke miratuar sipas rastit dokumentin për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar, të cilat prej kohësh nuk marrin zgjidhje.

Menjëherë

Përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

MTM (Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave), ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e ardhura nga subjektet për shfrytëzimin e mermerëve dhe ju ka informuar për

statusin e tyre. Për subjektet të cilat kanë dokumentacion të plotë, MTM duke mbajtur në konsideratë përcaktimet sipas pikës 1, neni 12, të ligjit 57/2020, "Për pyjet", "...për shkak të vlerës dhe rëndësisë, pyjet janë pasuri kombëtare dhe trajtohen si të tilla. Funkzioni i pyjeve si një e mirë publike prevalon mbi çdo interes tjetër të çdo subjekti dhe garantohet me vendosjen e kufizimeve përkatëse. Institucionet shtetërore garantojnë trajtimin prioritar të pyjeve sipas statusit të tyre "pasuri kombëtare" dhe interesit publik që ato përmbushin", miratimi i heqjes nga fondi pyjor lidhet edhe me faktin që deri tani nuk është kryer asnjë lloj rehabilitimi. Rehabilitimi si detyrim i lejeve të shfrytëzimit minerar, nuk është i lidhur me detyrimin e pyllëzimit kompensues si rezultat i heqjes nga fondi pyjor dhe duhet të ishte kryer në mënyrë periodike sipas planit të rehabilitimit të miratuar i cili është kusht për miratimin e lejes së shfrytëzimit minerar. Heqja nga fondi pyjor dhe detyrimi i pyllëzimit kompensues nuk është kusht i realizimit të planit të rehabilitimit. Realizimi i planit të rehabilitimit është një nga kushtet për revokimin e lejes së shfrytëzimit. Gjithashtu, MTM, në përputhje me dispozitat sipas pikës 2, të nenit 37, të ligjit Nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ka vlerësuar se, subjekti ka detyrimin e rehabilitimit të mjedisit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë (progresiv) ashtu edhe rehabilitimin përfundimtar dhe kthimin e tij në gjendje të rehabilituar, si dhe të raportojë *periodikisht* ecurinë e planeve të rehabilitimit çdo 6 muaj pranë AKM, në përputhje me pikën 5, të udhëzimit të përbashkët të ministrit të MTM dhe MIE Nr. 19 datë 24.08.2022, "Për miratimin e formatit standard për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit në veprimtaritë minerare "ku citohet se, "Subjektet minerare kanë detyrimin të raportojnë çdo 6 muaj SHGJSH/AKBN (sipas llojit të lejes minerare) dhe në AKM mbi ecurinë e rehabilitimit mjedisor progresiv dhe menaxhimin të mbetjeve të dala nga veprimtaritë minerare, në zbatim të ligjit Nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar". Në përfundim, sipas dispozitave të sipërcituara, si dhe mbështetur në parimin "ndotësi paguan", është vlerësuar se subjekti, përpara miratimit të kërkesës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për heqjen nga fondi pyjor, duhet të paraqesë dokumentacionin e detajuar provues përkatës të përcaktuar në ligjin për sektorin minerar dhe udhëzimit të përbashkët të ministrit të MITM dhe MIE mbi tërësinë e veprimtarive që përfshijnë rehabilitimin e mjedisit, progresiv të zonës së lejuar minerare. Për sa më sipër, është dërguar shkresë zyrtare subjekteve për të sjellë informacionin e rehabilitimit, dy prej të cilave i gjeni bashkëlidhur dhe do të vijohet me dërgimin e kërkesës për informacionin lidhur me rehabilitimin, për subjektet e tjera. Gjithashtu, viti 2024 u shpall "Viti i Pyjeve", dhe në këtë kuadër u promovuan mbjelljet në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për sa më sipër, nuk mund të promovohet heqje nga fondi pyjor i sipërfaqeve prej qindra ha (mbani në konsideratë që disa prej projektave të përgatitur për heqje nga fondi pyjor, janë me sipërfaqe të madhe prej 89 ha, 20 ha, etj.).

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Së pari sqarojmë se gjetja dhe rekomandimi i mësipërm nuk ka të bëjë me rehabilitimin mjedisor por vetëm me miratimin e dokumentit për ndryshimin të sipërfaqeve të fondit pyjor i cili siç kemi theksuar edhe në Raportin e Auditimit dhe bazuar në nenin 5 pika 4 të Ligjit nr 57/2020 "Për pyjet" në varësi të sipërfaqes bëhet me miratimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, VKM dhe/ose ligj të veçantë. Në Raportin e Auditimit ne jemi shprehur për subjektet që kanë kërkuar dhe kanë aplikuar për miratimin e dokumentit për heqje nga fondi pyjor të sipërfaqeve të shfrytëzuara për aktivitet minerar dhe për të cilat nevojitet një miratim ose refuzim (në varësi të specifikave teknike). Pikërisht për këtë shprehemi edhe në rekomandimin e mësipërm. Në argumentin tuaj të cituar më sipër, ju e adresoni fokusin të rehabilitimit mjedisor, që është një çështje e trajtuar në tjetër pyetje audituese dhe për të cilën është përgjegjësi e AKBN dhe AKM sic edhe jemi shprehur në raport. Në përgjigjen tuaj ju konkludoni që meqë subjektet nuk kanë bërë rehabilitime mjedisore, prandaj nuk janë bërë miratime për heqje nga fondi pyjor. Kjo nuk qëndron.

Kuadri ligjor/rregullator parashikon se rehabilitimi mjedisor si proces fillon pasi subjekti të zhvillojë aktivitetin, ndërsa heqja nga fondi pyjor duhet të bëhet para se subjekti të fillojë aktivitetin minerar. Thelbi i rekomandimit tonë ka qenë vetëm miratimi (ose dhe mos miratimi nëse subjektet nuk i plotësojnë kushtet) i kërkesave për heqje nga fondi pyjor kanë bërë ndër vite dhe për të cilat nuk është dalë në një vendim përkatës. Ndaj edhe ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pa zbatuar

Gjetje nga auditimi 2:

Sipërfaqja “*de facto*” ose reale e fondit pyjor është ulur me 0.89 km². Duke qenë se subjekteve nuk i është miratuar ndryshimi/heqja nga fondi pyjor, këto sipërfaqe rezultojnë ende në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor, kur aktualisht ato janë sipërfaqe e shfrytëzuar si aktivitet minerar. Mos miratimi nga Ministri, VKM, ose Ligj për heqje nga Fondi Pyjor bën që subjektet të mos marrin masa për kompensimin e shpyllëzimit që ato kanë kryer dhe do të vazhdojnë të kryejnë.

Gjetje nga auditimi 3:

Subjektet të cilat nuk kanë bërë kërkesën për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve të fondit pyjor që ata shfrytëzojnë janë si më poshtë:

- Subjekti “F” sh.p.k. me leje minerare nr. 970/2, datë 6.9.2006;
- Subjekti “K. K” sh.p.k. me leje minerare nr. 1051/1 datë 3.8.2017;
- Subjekti “M” sh.p.k. me leje minerare nr. 1930 datë 24.3.2022;
- Subjekti “A” sh.p.k. me leje minerare nr. 1918 dt 12.7.2021;
- Subjekti “B” sh.p.k. me leje minerare nr. 1888 datë 30.12.2019;
- Subjekti “D” sh.p.k. me leje minerare nr. 1811 datë 12.7.2016;
- Subjekti “H. F.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1703 datë 23.5.2014;
- Subjekti “W. S.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1653 datë 7.8.2013.

Nga mos aplikimi i këtyre subjekteve për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të destinuar për aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit shuma e munguar në buxhetin e shtetit është 160,000 lekë.

3.1 Rekomandimi:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve të marrin masa të detyrojnë të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit të aplikojnë për ndryshim/heqje të sipërfaqes së fondit pyjor.

Brenda muajit Maj 2024 e në vazhdimësi

Përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Së pari, kërkesa për heqje nga fondi pyjor për sipërfaqen e miratuar për shfrytëzim minerar, bëhet nga subjekti dhe nuk iniciohet nga MTM dhe mënyra e aplikimit është e përcaktuar në VKM nr.888/2022.

Gjithashtu, është e përcaktuar edhe në Ligjin Minerar nr.10304, datë 15.07.2010, të ndryshuar me Ligjin nr. 134/2014, neni 24, pika 10 ku citohet se :

Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtime zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullësor, pronë shtetërore, zëri " Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore", dhe regjistrohet në zërin "Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare", sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullësor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për

veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin." Së dyti, MTM nuk mban kadastrën minerare e cila mbahet nga AKBN dhe nuk është në dijeni të lejeve minerare të miratuara dhe subjektet të cilat kanë përfituar këto leje.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Së pari, sic jemi shprehur edhe në Raportin Përfundimtar, sqarojmë se:

AKP në kuadër të sigurimit të performancës në sektorin e pyjeve, si dhe vlerësimit të gjendjes së pyjeve dhe impaktit të sektorit, kryen:

- a) monitorimin e treguesve kyç dhe nivelit të realizimit të politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar nga strukturat përgjegjëse në bashki për pyjet;
- b) mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore/nënligjore, akteve administrative, politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar nga strukturat e kontrollit të pyjeve në bashki dhe në zonat e mbrojtura, si dhe ndërhyrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në rastet kur vëren pamundësinë ose mos ushtrimin e kompetencave ligjore nga ana e tyre.¹ Bazuar në këtë përcaktim ligjor është mbështetur edhe rekomandimi ynë i mësipërm, në mënyrë që Agjencia Kombëtare e Pyjeve të iniciojë aplikimin për heqje nga fondi pyjor për subjektet që nuk kanë aplikuar, të identifikuar këto në gjetjen e mësipërme. Duke qenë se asgjë nuk është bërë lidhur me këtë rekomandim, ai do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pa zbatuar

Nënpyetja 4.2.2 A ka funksionuar sistemi i kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të shfrytëzimit të mermerëve? (Trajtuar më hollësisht në fq. 41- 51 të Raportit Përfundimtar)

Gjetje nga auditimi 1:

Nga të dhënat e raportuara evidentohet se sipërfaqja e shfrytëzuar rezulton të jetë 0.8879 km², ndërsa sipërfaqja e prekur nga rehabilitimi i mjedisit progresiv ose përfundimtar është 0. Në Raportet Vjetore të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore subjekteve të mëposhtme u janë lënë detyrë për realizimin e rehabilitimit mjedisor të zonës së shfrytëzuar dhe konkretisht:

Për vitin 2021

- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 1051/1, datë 03.08.2007;
- ✓ Subjekti X.p.k. me leje minerare nr. 1835, datë 30.06.2017;
- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 1792/1, datë 10.03.2016.

Për vitin 2022

- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 1561, datë 22.05.2012;
- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 1604/1, datë 07.01.2013;
- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 1051/1, datë 03.08.2007;
- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 1026/2, datë 27.06.2007;
- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 1905, datë 18.01.2021;
- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 1792/1, datë 10.03.2016;
- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 862/2, datë 26.05.2005;
- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 970/2, datë 06.09.2006;
- ✓ Subjekti X sh.p.k. me leje minerare nr. 1661/2, datë 06.11.2014.

1.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të vlerësojë sipërfaqet e prekura nga aktiviteti i shfrytëzimit minerar të mermerit dhe

¹ Ligji nr 57/2020 "Për Pyjet" neni 35, pika 1

sipas rastit të sigurojë që subjektet të kryejnë rehabilitimin progresiv/përfundimtar të sipërfaqeve të shfrytëzuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Siç kemi theksuar edhe në korrespondencat e mëparshme, vizitat e përbashkëta në disa nga subjektet minerare që operojnë në shfrytëzimin e mineraleve GMMD dhe afati i mbetur i këtyre lejeve, theksojmë edhe një herë që subjektet private janë në proces shfrytëzimi dhe nuk janë krijuar akoma kushte për rehabilitimin e sipërfaqes së prekur nga aktiviteti minerar. Veçojmë në këtë rast subjektin M. Gj. shpk. zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit nr 1905 datë 18.01.2021, i cili ka kryer rehabilitimin e plotë të sipërfaqes së prekur dhe ka dorëzuar pranë AKBN planin e mbylljes dhe rehabilitimit përfundimtar të objektit.

Për subjektin S. P. shpk. zotërues i lejes minerare të shfrytëzimit nr 862/2 datë 06.09.2006, ka aplikuar për shtyrjen e afatit të lejes minerare për 10 vjeçarin e 3-të ku njëkohësisht ka planifikuar rehabilitimin progresiv të shkallëve të sipërme të karrierës (në pjesën jugore të saj) aty ku ka mbaruar shfrytëzimi dhe nuk ka rezerva minerare.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Siç jemi shprehur edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe konkretisht në gjetjen nr. 1 më sipër, nga vet AKBN, subjekteve të sipërcituara u janë lënë detyra për të bërë realizimin e rehabilitimit mjedisor të zonës së shfrytëzuar. Megjithatë sic jemi shprehur edhe në Akt Verifikimin e protokolluar në AKBN nga ana e grupit të auditimit me nr 268 prot. datë 15.01.2025, duke qenë se AKBN nuk ka vendosur në dispozicion dokumente faktuese lidhur me rehabilitimin e bërë nga subjekti “M. Gj.”, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pa zbatuar

Gjetje nga auditimi 2:

Akt-Konstatimet nuk përmbajnë të dhëna të plota e të sakta për të gjitha operacionet e veprimtarisë sipas planit vjetor të miratuar. Në asnjë prej tyre nuk jepet sipërfaqja që duhet rehabilituar sipas viteve të shfrytëzimit, nuk lihen detyra konkrete dhe as nuk evidentohen shkeljet ligjore që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatim të legjislacionit minerar. Monitorimi e mbikëqyrja e veprimtarive minerare nuk është kryer e plotë dhe dy herë në vit sipas dispozitave të ligjit minerar në RSH-së. Është konstatuar se për periudhën 2020-2022, nuk janë monitoruar dy herë/vit 3 nga 7 subjektet e përzgjedhura për auditim (subjekti “D. V.” sh.p.k. me leje minerare nr.1225/1, datë 24.12.2012, subjekti “T. E.” sh.p.k. me leje minerare nr.1661/2, datë 06.11.2014 dhe subjekti “M. C.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1790/1, datë 21.01.2016). Për vitin 2020 dhe 2021 nuk është monitoruar dy herë në vit subjekti “A.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1604, datë 7.1.2013. Për vitin 2020 dhe 2022 nuk është monitoruar dy herë në vit subjekti “A.” sh.p.k. me leje minerare nr.1792/1, datë 10.03.2016.

2.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masat e nevojshme për të kryer me përpikmëri dy herë në vit monitorimin e veprimtarisë minerare të çdo subjekti në vendin e ushtrimit të aktivitetit.

Në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Gjatë vitit 2024, në zbatim edhe të VKM nr 506 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr 547 datë 09.08.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, AKBN kaloi në një proces ristrukturimi dhe organizimi. Sektori i Monitorimit Minerar, pranë Drejtorisë së Monitorimit është përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë minerare të subjekteve private që ushtrojnë aktivitetet minerar

shfrytëzimi në vendin tonë. Për vitin 2024, është bërë i mundur monitorimi vetëm 1 herë i të gjitha subjekteve që janë licencuar dhe ushtrojnë aktivitet minerar në vendin tonë, përfshirë këtu edhe subjektet që zotërojnë leje minerare shfrytëzimi për mineralin GMMD. Për periudhën në vazhdim, sipas një planifikimi të detajuar, do të mbikëqyren të gjitha subjektet private që zotërojnë leje minerare shfrytëzimi të paktën dy herë në vit.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Duke qenë se siç pohohet edhe nga AKBN, subjektet që zotërojnë leje minerare shfrytëzimi për mineralin GMMD nuk janë monitoruar dy herë në vit, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pa zbatuar

Gjetje nga auditimi 3:

Subjektet që kryejnë aktivitet minerar të shfrytëzimit të mermerit zotërojnë leje mjedisi “Tipi B” në kushtet e së cilës përcaktohet edhe dorëzimi dy herë në vit i Raporteve të Vet Monitorimit të Lejes Mjedisore. Konstatohet se për periudhën 2020-2022 nuk janë dorëzuar dy herë në vit (për periudhën 2020-2022) Raportet e Vet Monitorimit të “Lejeve Mjedisore Tipi B” nga subjektet me leje mjedisi nr. PN-0131-11-2020, PN-0266-02-2021, PN-9060-07-2019, PN-3102-06-2016, PN-6834-02-2014.

3.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa ndëshkuese gjatë inspektimeve në terren për subjektet të cilat nuk kryejnë dorëzimin e raporteve të vet monitorimit dhe t’i vlerësojë këto si subjekte me potencial risku.

Menjëherë e në vazhdimësi

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nuk i është përgjigjur emailit zyrtar të dërguar nga grupi i auditimit në adresën info@akm.gov.al dhe a.d@akm.gov.al më datë 18.12.2024.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Për arsye të mos përgjigjes ndaj emailit të cituar më sipër, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I pa zbatuar

Gjetje nga auditimi 4:

Subjekti “K. K.” sh.p.k. me leje minerare shfrytëzimi nr.1051/1, datë 03.08.2007 zhvillon veprimtari minerare pa disponuar lejen mjedisore, duke qenë në mos përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin minerar dhe mjedisor.

4.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit nëpërmjet një grupi të përbashkët pune të inspektojnë subjektin “K. K.” sh.p.k. me leje minerare të shfrytëzimit nr.1051/1, datë 03.08.2007, për zbatimin e kushteve të lejes minerare dhe mjedisore.

Menjëherë

Përgjigje e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Sektori i Monitorimit Minerar, në Drejtorinë e Monitorimit, në muajin Dhjetor 2024 kreu mbikëqyrjen në objektin e Gëlqerorit të Mermerizuar “K.”, Bashkia Kukës, në lejen minerare të shfrytëzimit nr.1051/1, datë 03.08.2007. Në objekt, nuk ushtrohet aktivitet minerar në momentin e kontrollit për shkak të kushteve atmosferike.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Ju lutemi të sillni evidenca dhe dokumentacion faktues që vërtetojnë kontrollin e bërë nga AKBN në këtë subjekt në dhjetor 2024 në mënyrë që ky rekomandim të konsiderohet i zbatuar. Në të kundërt ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

IV. TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE

Nëpërmjet shkresës nr. 268/3 prot., datë 11.03.2025 protokolluar në KLSH me nr. 1478/8 prot., datë 12.03.2025, AKBN ka dërguar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna referuar Projekt Raportit të zbatimit të rekomandimeve.

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit rikërkojmë nga MIE, MTM, AKBN dhe AKM zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 448/14, 448/15, 448/16, 448/17, datë 29.12.2023, për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve”.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Për nënpyetjen 4.1.1 A janë hartuar dhe zbatuar politika dhe objektiva të përshtatshme në funksion të shfrytëzimit të mermerëve?

Gjetje nga auditimi 1:

Ligji minerar dhe Ligji për Taksat Kombëtare nuk janë të harmonizuar me njëri-tjetrin sa i përket përdorimit të terminologjisë mbi mineralin e mermerit. Në Ligjin minerar nuk përdoret emërtimi “mermer”, por gëlqeror i mermerizuar, ndryshe nga Ligji për Taksat Kombëtare i cili përdor emërtimin “mermer” në shtojcën nr. 2 të tij dhe për të cilin ka të përcaktuar edhe vlerën prej 4095 lek/m³. Kjo situatë sjell një konfuzion në përkufizimin e qartë të termit të mermerit e cila evidentohet edhe në përlllogaritjen e rentës minerare për subjektet që shfrytëzojnë GMMD.

1.1 Rekomandimi:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për harmonizimin dhe unifikimin e përkufizimit dhe përcaktimit të qartë të mineralit të mermerit në ligjin minerar dhe atë për taksat kombëtare.

Në vazhdimësi

B. MASA ORGANIZATIVE

Për nënpyetjen 4.1.1 A janë hartuar dhe zbatuar politika dhe objektiva të përshtatshme në funksion të shfrytëzimit të mermerëve?

1. Gjetje nga auditimi: Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë është e mangët, pa indikatorë matës për të gjithë periudhën e veprimtarisë së saj (2010-2025) për disa aspekte të ndryshme si për shembull vlera e investimeve në sektorin minerar, numri i punonjësve të punësuar në sektorin minerar dhe nën sektorët e tij etj. Lidhur me Monitorimin dhe Raportimin mbi ecurinë e Strategjisë Minerare të Shqipërisë nuk është përgatitur asnjë Relacion/Raport që të dëshmojë mbi synimet dhe objektivat e saj. Në Strategjinë Minerare të Shqipërisë nuk përcaktohet ngritja dhe detyrimi i ndonjë strukture për të monitoruar treguesit e saj, ndryshe sa përcaktohet në Strategjinë Minerare të Suedisë.

1.1 Rekomandimi:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në hartimin e Strategjisë së re Minerare, të marrë masa për përcaktimin e indikatorëve për gjatë gjithë periudhës kohëzgjatjes së saj si dhe të përcaktojë qartë njësinë apo strukturën e cila do të monitorojë periodikisht atë.

Me miratimin e Strategjisë së re Minerare

Nënpyetja 4.1.2 Si ka qenë ecuria e të ardhurave të realizuara nga sektori i shfrytëzimit të mermerëve? (Trajtuar më hollësisht në fq. 27- 36 të Raportit Përfundimtar)

2. Gjetje nga auditimi:

Në sektorin e shfrytëzimit të GMMD, 63 % e lejeve minerare i përkasin emërtimit “Gëlqeror i mermerizuar”. Prodhimi në fund të vitit 2022 në sektorin e shfrytëzimit të GMMD rezulton 27,279 m³ nga 12,537 m³ që ka qenë në vitin 2020. Të ardhurat e subjekteve që shfrytëzojnë GMMD nga shitjet (brenda dhe jashtë vendit) rezultojnë të jenë 592,155,168 lekë për vitin 2022 duke shënuar një rritje të lartë në raport me të ardhurat nga shitjet për vitin 2020 të cilat kanë qenë 230,054,425 lekë. Volumi i produktit të shitur të GMMD (në m³) ka shënuar rritje nga 11,011 m³ në vitin 2020 në 24,927 m³ në vitin 2022. Pavarësisht rritjes së volumit të shitur mbi të cilin përlllogaritet renta minerare, ecuria e kësaj të fundit ka shënuar trend zbritës për periudhën objekt auditimi nga 13,320,612 lekë në vitin 2020 në 8,888,552 në vitin 2022.

Gjetje nga auditimi:

Përgjatë periudhës objekt auditimi rezultojnë disa subjekte të cilat në Lejen Minerare kanë emërtimin “Gëlqeror i mermerizuar” dhe nuk e paguajnë rentën minerare sipas përcaktimit të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Shtojca nr. 2, Grupi IV numri 22. I njëjti fenomen përsëritet edhe për subjekte të tjera të cilat në Lejen Minerare kanë emërtimin “Gëlqeror dekorativ” dhe nuk e paguajnë rentën minerare sipas përcaktimit të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Shtojca nr. 2, Grupi IV numri 36.

2.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për të gjithë subjektet që shfrytëzojnë Gëlqerorët Masiv, të Mermerizuar dhe Dekorativ, të marrë masa për të unifikuar pagesën e rentës minerare bazuar në emërtimin e mineralit që përmban Leja Minerare e shfrytëzimit.

Menjëherë e në vijimësi

Nënpyetja 4.2.1 A janë miratuar kërkesat për heqje nga fondi pyjor të aktiviteteve të shfrytëzimit të mermerëve? (Trajtuar më hollësisht në fq. 36- 41 të Raportit Përfundimtar)

3. Gjetje nga auditimi:

Deri më sot asnjë prej subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit nuk janë të pajisur me aktin përkatës ligjor/nënligjor (Miratimin e Ministrit të MTM, VKM ose Ligj të veçantë) për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar. Ligji për pyjet përcakton qartë detyrimin e subjekteve për t'u pajisur me Miratimin e Ministrit të MTM, VKM ose Ligj të veçantë mbi ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar.

3.1 Rekomandimi:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat të shqyrtojë të gjitha kërkesat/aplikimet e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit, duke miratuar sipas rastit dokumentin për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar, të cilat prej kohësh nuk marrin zgjidhje.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

Sipërfaqja “*de facto*” ose reale e fondit pyjor është ulur me 0.89 km². Duke qenë se subjekteve nuk i është miratuar ndryshimi/heqja nga fondi pyjor, këto sipërfaqe rezultojnë ende në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor, kur aktualisht ato janë sipërfaqe e shfrytëzuar si aktivitet minerar. Mos miratimi nga Ministri, VKM, ose Ligj për heqje nga Fondi Pyjor bën që subjektet të mos marrin masa për kompensimin e shpyllëzimit që ato kanë kryer dhe do të vazhdojnë të kryejnë.

Gjetje nga auditimi:

Subjektet të cilat nuk kanë bërë kërkesën për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve të fondit pyjor që ata shfrytëzojnë janë si më poshtë:

- Subjekti “F.” sh.p.k. me leje minerare nr. 970/2, datë 6.9.2006;
- Subjekti “K. K” sh.p.k. me leje minerare nr. 1051/1 datë 3.8.2017;
- Subjekti “M.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1930 datë 24.3.2022;
- Subjekti “A.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1918 dt 12.7.2021;
- Subjekti “B.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1888 datë 30.12.2019;
- Subjekti “D.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1811 datë 12.7.2016;
- Subjekti “H. F.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1703 datë 23.5.2014;
- Subjekti “W. S.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1653 datë 7.8.2013.

Nga mos aplikimi i këtyre subjekteve për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të destinuar për aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit shuma e munguar në buxhetin e shtetit është 160,000 lekë.

4.1 Rekomandimi:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve të marrin masa të detyrojnë të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit të aplikojnë për ndryshim/heqje të sipërfaqes së fondit pyjor.

Brenda muajit Qershor 2025 e në vazhdimësi

Nënpyetja 4.2.2 A ka funksionuar sistemi i kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të shfrytëzimit të mermerëve? (Trajtuar më hollësisht në fq. 41- 51 të Raportit Përfundimtar)

5. Gjetje nga auditimi:

Nga të dhënat e raportuara evidentohet se sipërfaqja e shfrytëzuar rezulton të jetë 0.8879 km², ndërsa sipërfaqja e prekur nga rehabilitimi i mjedisit progresiv ose përfundimtar është 0. Në

Raportet Vjetore të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore subjekteve të mëposhtme u janë lënë detyrë për realizimin e rehabilitimit mjedisor të zonës së shfrytëzuar dhe konkretisht:

Për vitin 2021

- ✓ Subjekti “K. K.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1051/1, datë 03.08.2007;
- ✓ Subjekti “B. C” sh.p.k. me leje minerare nr. 1835, datë 30.06.2017;
- ✓ Subjekti “A.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1792/1, datë 10.03.2016.

Për vitin 2022

- ✓ Subjekti “Y. S.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1561, datë 22.05.2012;
- ✓ Subjekti “A.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1604/1, datë 07.01.2013;
- ✓ Subjekti “K. K.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1051/1, datë 03.08.2007;
- ✓ Subjekti “K.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1026/2, datë 27.06.2007;
- ✓ Subjekti “M. Gj.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1905, datë 18.01.2021;
- ✓ Subjekti “A.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1792/1, datë 10.03.2016;
- ✓ Subjekti “S. P.” sh.p.k. me leje minerare nr. 862/2, datë 26.05.2005;
- ✓ Subjekti “F.” sh.p.k. me leje minerare nr. 970/2, datë 06.09.2006;
- ✓ Subjekti “T. E.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1661/2, datë 06.11.2014.

5.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të vlerësojë sipërfaqet e prekura nga aktiviteti i shfrytëzimit minerar të mermerit dhe sipas rastit të sigurojë që subjektet të kryejnë rehabilitimin progresiv/përfundimtar të sipërfaqeve të shfrytëzuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Akt-Konstatimet nuk përmbajnë të dhëna të plota e të sakta për të gjitha operacionet e veprimtarisë sipas planit vjetor të miratuar. Në asnjë prej tyre nuk jepet sipërfaqja që duhet rehabilituar sipas viteve të shfrytëzimit, nuk lihen detyra konkrete dhe as nuk evidentohen shkeljet ligjore që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatim të legjislacionit minerar. Monitorimi e mbikëqyrja e veprimtarive minerare nuk është kryer e plotë dhe dy herë në vit sipas dispozitave të ligjit minerar në RSH-së. Është konstatuar se për periudhën 2020-2022, nuk janë monitoruar dy herë/vit 3 nga 7 subjektet e përzgjedhura për auditim (subjekti “D. V.” sh.p.k. me leje minerare nr.1225/1, datë 24.12.2012, subjekti “T. E.” sh.p.k. me leje minerare nr.1661/2, datë 06.11.2014 dhe subjekti “M. C.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1790/1, datë 21.01.2016). Për vitin 2020 dhe 2021 nuk është monitoruar dy herë në vit subjekti “A” sh.p.k. me leje minerare nr. 1604, datë 7.1.2013. Për vitin 2020 dhe 2022 nuk është monitoruar dy herë në vit subjekti “A” sh.p.k. me leje minerare nr.1792/1, datë 10.03.2016.

6.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masat e nevojshme për të kryer me përpikmëri dy herë në vit monitorimin e veprimtarisë minerare të çdo subjekti në vendin e ushtrimit të aktivitetit.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi:

Subjektet që kryejnë aktivitet minerar të shfrytëzimit të mermerit zotërojnë leje mjedisi “Tipi B” në kushtet e së cilës përcaktohet edhe dorëzimi dy herë në vit i Raporteve të Vet Monitorimit të Lejes Mjedisore. Konstatohet se për periudhën 2020-2022 nuk janë dorëzuar dy herë në vit (për periudhën 2020-2022) Raportet e Vet Monitorimit të “Lejeve Mjedisore Tipi B” nga subjektet me leje mjedisi nr. PN-0131-11-2020, PN-0266-02-2021, PN-9060-07-2019, PN-3102-06-2016, PN-6834-02-2014.

7.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa ndëshkuese gjatë inspektimeve në terren për subjektet të cilat nuk kryejnë dorëzimin e raporteve të vet monitorimit dhe t'i vlerësojë këto si subjekte me potencial risku.

Menjëherë e në vazhdimësi

Të tjera

Për të gjitha masat e dhëna të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar me statusin ***në proces zbatimi***, duke vlerësuar proceset e ndërmarra nga subjektet e audituara dhe afatet e nevojshme për implementimin e plotë të tyre, kërkohet përmbushja e plotë e tyre brenda **vitet 2025**.

Për sa më sipër u mbajt ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

